



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:263816
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05568024

AC-I-23-0271

Në çështjen juridike të:

Paditësi/Ankuesi

M G, i përfaqësuar nga Av. Sh R, nga Prizreni.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

NSH "Lavërtari - Blegtori" (në likuidim) Prizren, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha"- Lakërishtë, nr. 55, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Diellza Hoxha gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së, C-IV-22-0134 të datës 27 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Ankesa e AKP-së është pjesërisht e bazuar.**
- 3. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-të të DHPGJS-së, C-IV-22-0134 i datës 27 prill 2023, lidhur me interesin ligjor, ashtu që në vend të shumës 1,200.00 euro, në emër të interesit ligjor e paditura duhet ti paguajë paditësit shumën prej 1021.00 euro, ose në shumën totale, borxhi themelor dhe interesi ligjor në shumë prej**

11,240.40 euro, që do të paguhet sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Pjesa tjetër e Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-22-0134 i datës 27 prill 2023, vërtetohet.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 21 prill 2015, paditësi kishte parashtruar padi në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "D.L.B. Lavërtari-Blegtori" e administruar nga AKP (AL i AKP-së) PRZ009-0175 i datës 23 mars 2015. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e paditësit për dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 2,270.94 euro. AL i AKP-së arsyeton se duke u bazuar në arkivën e NSH-së si dhe në listën e pagave të punëtorëve aktiv për periudhën nga muaji gusht 2012 deri në muajin gusht 2013, AL kishte arritur në përfundim se për gjatë kësaj periudhe parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar shërbime për NSH dhe si pasojë rezulton se nuk ka qenë një punonjës aktiv i NSH-së. Duke u bazuar në këto konstatime, parashtruesi nuk mund të jetë pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga Agjencia, siç parashikohet në nenin 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Paditësi thekson se ka qenë në marrëdhënie pune në NSH duke filluar nga data 28 janar 1983, e deri më datën 06 shtator 2013. Marrëdhënien e punës e ka ndërprerë me datë 06 shtator 2013, si pasojë e fillimit të procedurës së likuidimit të ndërmarrjes në fjalë. Në lidhje me pretendimin se kërkesa e tij është parashkruar ka theksuar se në procedurën e likuidimit nuk njihet institucioni i parashkrimit të kërkesave. Po ashtu, në procedurën e likuidimit në cilësi të kreditorit mund të paraqiten edhe punëtorët të cilëve nuk u janë kompensuar pagat. Paditësi, ka theksuar se vendimi i atakuar me këtë padi nuk është i bazuar në ligj dhe si i tillë është i paqëndrueshëm, ngase në të nuk theksohen arsyet se mbi çfarë baze është refuzuar kërkesa e parashtruar në procedurën e likuidimit. Paditësi ka pretenduar se me vendimin e kundërshtuar i janë cenuar të drejtat fundamentale për shkak të pamundësisë së realizimit të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Paditësi ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadinë e tij si e bazuar dhe të ndryshohet vendimi i ankimuar si dhe të urdhërohet AL i AKP-së që t'ia kompensoj pagat e pretenduara në shumën prej 24.064,55 euro si dhe kamatën prej 10 për qind nga data 01 janar 2004 deri në pagesën definitive.

Në përgjigjen e saj të datës 03 shkurt 2021, AKP i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit dhe propozon që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Më 01 mars 2021 Shkalla e parë e DHPGJS-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-15-0446 me të cilin kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Sipas arsyetimit të dhënë, duke u bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve, NSH ka hyrë në procedurën e likuidimit më 07 korrik 2014 dhe me këtë rast i ka njoftuar punëtorët për ndërprerjen e kontratave të punës. Këtë veprim AL i AKP-së e ka mbështetur në nenin 9 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në. Shkalla e parë thekson se nga provat e shqyrtuar në këtë çështje juridike kontestimore gjykata nuk ka gjetur se pala paditëse ka qenë në marrëdhënie pune me NSH-në për vitet 2012-2013.

Sipas Shkallës së parë, paditësi kërkesën pranë AL të AKP-së e kishte parashtruar më 19 gusht 2014, rrjedhimisht sipas bindjes së gjykatës kërkesa e palës paditëse për pagat e pretenduara është parashkruar bazuar në nenin 367 paragrafi 1 të LMD-së (1978).

Më 15 prill 2021, paditësi kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi për shkak të gjitha arsyeve ankimore. Ai thekson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban asgjë lidhur me faktet vendimtare për rastin i cili është objekt i lëndës. Gjkata nuk i ka vlerësuar provat veç e veç, duke mos dhënë fare shpjegim të qartë për vendimmarrjen. Gjkata nuk ka bërë shqyrtim të gjithanshëm të ankesës-padisë së parashtruar, pra nuk janë administruar provat e bashkangjitura, vendimi nuk përmban arsyetim të veçantë, aktgjykim është i shoqëruar me shkelje të dispozitave të LPK-së, nenit 9 të Ligjit për Dhomën e Posaçme si dhe arsyetimi ka të meta. Ankuesi thekson se gjykata nuk e ka cekur se në rastin konkret nuk mund të zbatohet neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar, pasi që kjo çështje rregullohet me ligj të veçantë. Paditësi thekson se në këtë çështje rregullat e parashkrimit nuk mund të zbatohet sepse i vetmi veprim i paditësit ishte kërkesa e parashtruar pranë AL të AKP-së në afat dhe procedura e likuidimit është e rregulluar me ligj të veçantë – Ligjin për AKP-në, prandaj afatet rrjedhin nga momenti kur AL i AKP-së e ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH. Paditësi iu është referuar edhe disa raste nga praktika gjyqësore e DHPGJSK-së për të cilat

pretendon se janë të ngjashme me rastin e tij. Ankuesi propozoi që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet plotësisht, ashtu që padia të aprovohet në tërësi si në kërkesëpadi, apo të urdhërohet rigjykimi i lëndës.

Më 08 tetor 2021 paditësi përmes një parashtrese ka bërë precizimin dhe plotësimin e ankesës. Ai thekson se paditësi tek AL i AKP-së ka dorëzuar formularët me kërkesat për kompensimin e 3 pagave të fundit, 7 paga dhe për pagat e pa paguara për vitin 2004 deri në vitin 2013 në shumën prej 23.031,29 euro. Ankuesi me këtë rast bënë të ditur se ai i kundërshton Vendimet PRZ009-0174, PRZ009-0175 dhe PRZ009-0177.

Me Vendimin PRZ009-0174 të datës 30 mars 2015, ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e tri pagave të pa paguara për periudhë të pa caktuar në shumën prej 973.26 euro. Me PRZ009-0175 të datës 23 mars 2015 ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 2.270,94 euro, ndërsa me Vendimin PRZ009-0177 të datës 03 prill 2015 ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 23.091,29 euro.

Dy vendimet e para arsyetohen me faktin se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së në kohën e privatizimit dhe AKP nuk ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës pasi që ai nuk ka qenë në marrëdhënie pune.

Vendimin PRZ009-0177 AL i AKP-së e ka arsyetuar me faktin se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar.

Me datë 13 maj 2022, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-21-0246-A0001 e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe lëndën e kthen në rigjykim në Shkallën e I-rë të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se me Vendimin e AL të AKP-së me të cilat ka administruar Shkalla e parë, ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 2.270,09 euro. Me kundërshtimin ndaj këtij vendimi, avokati i palës paditëse e kishte cekur vetëm këtë vendim dhe kishte kërkuar që të kompensoj pagat e pa paguara për vitin 2004 deri në vitin 2013 në shumën prej 24.064,55 euro. Shkalla e parë këtë kërkesë e kishte refuzuar si të pa bazuar me arsyetimin se nga provat e shqyrtuara në këtë çështje juridike kontestimore është e qartë se objekt i shqyrtimit ishte kërkesëpadi për pagat e pa paguara nga viti 2004 deri në vitin 2013, por gjykata nuk ka gjetur se pala paditëse ka qenë në

marrëdhënie pune me NSH-në për vitet 2012-2013, andaj kërkesa është parashkruar konform nenit 376 paragrafi 1 i LMD-së(1978).

Kolegji i Apelit konstaton se vlerësimi i Shkallës së parë se, nuk është dëshmuar që paditësi të ketë qenë punëtor aktiv në NSH për periudhën 2012-2013, nuk është i saktë sepse provat e prezantuara edhe para Shkallës së parë, siç janë - librezat e punës, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i datës 06 shtator 2013, por edhe listat bankare të pagave, dëshmojnë të kundërtën e asaj që ka konstatuar Shkalla e parë. Pra, në bazë të librezës së punës dëshmohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 06 shtator 2013, e në të njëjtën ditë i është dërguar Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Bazuar edhe në listat e pagave që janë dorëzuar për të gjitha periudhat e pretenduara, është e qartë se në këtë rast konkret nuk kemi as parashkrim të kërkesës, siç ka konstatuar Shkalla e parë. Kolegji i Apelit vëren se përfaqësuesi me prokurë i paditësit edhe para Shkallës së parë nuk e ka përfaqësuar në mënyrë të denjë paditësin, pasi që nuk i ka kundërshtuar tri vendimet e lëshuara nga AL i AKP-së, edhe pse ka kërkuar një shumë prej më shumë se 24 mijë eurosh, që pak a shumë është shuma e përgjithshme e të tri vendimeve, por e ka kundërshtuar vetëm njërin prej tyre. Këtë është dashur që ta vërej edhe Shkalla e parë e DHPGJSK-së, pasi që avokati në kundërshtimin e tij e përmend Vendimin PRZ009-0175, ndërsa shuma që ishte refuzuar nga AL i AKP-së dhe shuma që kërkohet me kundërshtimin e këtij vendimi nuk janë të përputhshme. Bazuar në nenin 11, paragrafi 2, "Gjykata duhet ta udhëzoj edhe palën që është e përfaqësuar nga avokati për veprimet procedurale, kur konsideron se përfaqësuesi nuk është duke e kryer punën në mënyrë profesionale". Kolegji i Apelit vëren se në Shkallë të dytë para Kolegjit të Apelit i njëjti përfaqësues me prokurë, vetëm me precizimin e ankesës, ka bërë kundërshtimin e të tre vendimeve të AL të AKP-së, duke kërkuar shumën prej 23.031,29 euro. Në këtë fazë të procedurës, paditësi ka ofruar edhe një dëshmi shtesë, Njoftimin e datës 14 korrik 2014 ku thuhet se, nga të dhënat e ndërmarrjes tregon se ju mund të keni kërkesë ndaj ndërmarrjes ose aseteve të saj. Prandaj po bashkëngjisin formularin e kërkesave të likuidimit dhe do të jemi mirënjohës nëse e ktheni atë në zyrën qendrore të AKP-së, nëse kërkesën nuk e ktheni para datës 27 gusht 2014, kjo përbënë element të mjaftueshëm për refuzimin e kërkesës suaj. Paditësi kërkesën e tij tek AL i AKP-së e kishte parashtruar në afatin e përcaktuar, gjegjësisht më 19 gusht 2014.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim lënda ka marrë numrin C-IV-22-0134.

Me datë 03 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një urdhër për paditësin me të cilin kërkohet të dorëzohet dokumentacioni i kërkuar nga Kolegji i Apelit, duke paralajmëruar se nëse nuk dorëzohen dëshmitë e kërkuara do të vendoset në bazë të shkresave të lëndës që janë në dispozicion.

Me datë 15 shkurt 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrit. Në këtë parashtresë ai ka përsëritur pretendimet e veta që i kishte cekur më herët në ankesë. Bashkë me këtë parashtresë paditësi ka dorëzuar kopjen e Librezës së punës, e mbyllur 06 shtator 2013, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, njoftimin e AKP-së për mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit, dy vendimet e ankimuarra të Autoritetit të Likuidimit, një listë të punëtorëve të lëshuar nga NSH-ja me datë 11 tetor 2012, pranimin e njoftimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës - regjistër, një listë të lëshuar nga NSH për të ardhurat personale të punëtorëve.

Me datë 27 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0134 e aprovon ankesën e paditësit pjesërisht si të bazuar, i ndryshon vendimet e Autoritetit të Likuidimit PRZ009-0175 të datës 23 mars 2015 dhe PRZ009-0177 të datës 03 prill 2015, e detyron AKP-në që paditësi në emër të pagave të pa paguara për 36 paga përgjatë periudhës shtator 2010 – gusht 2013 ti paguajë paditësit shumën prej 10.219,40 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 1,200.00 euro ose totalin për pagesë prej 11,419.40 euro, si dhe ka detyruar AKP-në që në emër të 7 pagave të pa paguara për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ti paguajë paditësit shumën prej 1,951.60 euro si dhe interesin ligjor prej 10% në shumë prej 196.00 euro ose totali prej 2,147.83 euro. Me pikën e dytë të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesës si e pa bazuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa e paditësit për paga për periudhën shtator 2010 deri shtator 2013 nuk është parashkruar siç pretendon AKP-ja por pagat tjera të mëhershme janë parashkruar. Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013 dhe mbyllja e Librezës së punës me të njëjtën datë, e ka ndërprerë parashkrimin për tri vite paraprake, respektivisht pagat nga muaji shtator 2010 deri në gusht 2013 nuk mund të konsiderohen të parashkruara. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se bazuar në provat e ofruara nga paditësi atij i njihet e drejta në pagesën

e pagave të pa paguara për periudhën shtator 2010 – gusht 2013 në shumë prej 10,219.40 euro, ndërsa edhe interesi ligjor prej 10% në shumë prej 1,200.00 euro. Shkalla e I-rë me Aktgjykimin e ankimuar konstaton se objekt shqyrtimi ishte edhe kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e që në bazë të provave të paraqitura paditësit i takojnë 7 paga mujore në shumë prej 2,270.09 euro, pasi që i njëjti i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësit po ashtu i është njohur edhe e drejta në interes ligjor lidhur me kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës prej 10% në borxhin kryesor ose në shumën prej 196.00 euro.

Me datë 12 maj 2023, paditësi përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër pikës **III** të dispozitivit të Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0134 të datës 27 prill 2023 dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet pika III e dispozitivit të Aktgjyimit të ankimuar dhe lënda të kthehet në rivendosje, ose të ndryshohet kjo pikë e dispozitivit dhe të aprovohet edhe pjesa e kërkesës për pagat nga janar 2005 e deri në gusht 2010 në shumë prej 13,384.14 euro, si dhe interesi ligjor prej 1,338.40 euro. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se kërkesa për paga nuk është parashkruar lidhur me periudhën për të cilën është refuzuar kërkesa për faktin se Gjykata nuk duhet të zbaton institutin e parashkrimit sipas detyrës zyrtare dhe kjo e drejtë e palëve është e garantuar me ligj. Tutje paditësi pohon se në këtë rast nuk mund të aplikohen rregullat e përgjithshme për parashkrimin e kërkesave sepse asnjë punëtor nuk mund ti realizojë kërkesat kreditore ndaj një NSH-je po të mos ketë filluar procedura e likuidimit. Tutje paditësi pohon se edhe sipas nenit 46 të Ligjit për Falimentimin është përcaktuar se kërkesat e pa arritura do të konsiderohen të arritura në momentin kur Gjykata, në këtë rast Autoriteti i Likuidimit vendos për hapjen e falimentimit të një NSH-je.

Me datë 18 maj 2023, përmes postës AKP-ja e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0134 të datës 27 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet pjesa aprovuese e Aktgjyimit të ankimuar, dhe të refuzohet ankesa e paditësit e paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si e pa bazuar. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se

Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlidhet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtroj kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së, ai nuk ishte në Listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit të NSH "Lavërtari - Blegtori", andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Bazuar në këto arsye paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, dhe as kërkesa për paga për periudhën nga shtator 2010 – gusht 2013 në shumë prej 10,219.40 euro, siç ka vendosur gabimisht Shkalla e I-rë e DHPGJS-së. AKP-ja ka kërkuar që edhe njëherë DHPGJS-ja të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të merren në konsideratë argumentet e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 16 qershor 2023, paditësi e pranoi ankesën e AKP-së mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Me datë 04 korrik 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi i ligjor

Ankesat refuzohen si të pa bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Meritat e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Kolegji i Apelit vëren se me Aktvendimin e tij AC-I-21-0246-A0001 të datës 13 maj 2022, e kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe e kishte anuluar Aktgjykimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0446 të datës 01 mars 2021, duke e kthyer lëndën në rigjykim, meqë nuk ishte pajtuar me konstatimin e Shkallës së I-rë dhe të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është tërësisht e parashkruar. Kolegji i Apelit me këtë Aktvendim kishte konstatuar se pagat e kërkuara nga muaji shtator 2010 e deri në gusht 2013 nuk janë parashkruar marrë për bazë faktin se me njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013, është ndërprerë rrjedha e parashkrimit të kërkesës për këtë pjesë të periudhës kohore. Kolegji i Apelit po ashtu kishte konstatuar se pagat tjera të kërkuara më herët për periudhën nga viti 2004 e deri në gusht 2010 janë parashkruar, për faktin që paditësi nuk ka dorëzuar prova që vërtetojnë ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshon një urdhër për paditësin me të cilën kërkohet që ai të dërgon prova shtesë, të kërkuara me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit.

Paditësi me parashtresën e tij të dorëzuar me 15 shkurt 2023 ka dorëzuar provat vijuese: kopjen e Librezës së punës, e mbyllur 06 shtator 2013, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, njoftimin e AKP-së për mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit, dy vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit, një listë të punëtorëve të lëshuar nga NSH-ja me datë 11 tetor 2012, pranimin e njoftimeve mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës - regjistër, një listë të lëshuar nga NSH për të ardhurat personale të punëtorëve.

Bazuar në këto prova dhe në faktin që AKP-ja me mbrojtjen në ankesë shprehimisht nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkuar të kompensimit, Kolegji i Apelit konstaton se paditësit me të drejtë i është njohur e drejta në paga për 36 muaj ë periudhës

shtator 2010 – gusht 2013, në shumën prej 10,219.40 euro. Kolegji i Apelit vëren se në emër të interesit ligjor paditësit i është njohur 10% nga borxhi kryesor ose në shumë 1,200.00 euro, mirëpo kalkulimi i lartësisë së interesit ligjor që lidhet me borxhin e aprovuar në emër të pagave, nuk ishte i saktë. Paditësit i takon interesi ligjor prej 10% në shumën e borxhit të aprovuar ose 1021.94 euro, por jo shuma 1,200.00 euro, siç është vendosur me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji i Apelit e mbështet si të drejtë dhe të bazuar në ligj Aktgjykimin e ankimuar lidhur me kërkesën për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, pasi që nga provat e dorëzuara nga paditësi shihet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i veprimit të AKP-së për shkak të privatizimit të NSH-së. Andaj paditësi ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në bazë të përvojës së punë në NSH në 7 paga mujore nga 278.80 euro ose në shumën prej 1,951.60 euro. Paditësit po ashtu në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së i takon edhe e drejta në interes ligjor prej 10% ose në shumën prej 196.00 euro, të cilat shuma duhet të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së e paraqitur ndaj pjesës aprovuese të Aktgjykimit të ankimuar duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të paraqitur ndaj pikës **III** të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, ndaj pjesës refuzuese, ai e kundërshton konstatimin e Shkallës së I-rë se pagat e periudhës nga viti 2004 e deri në gusht 2010 është parashkruar. Ky kundërshtim i paditësit është i pa bazuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë asnjë provë të vetme me të cilën do të vërtetonte se pagat e kësaj periudhe kohore për të cilën është refuzuar kërkesa i ka kërkuar në afatin prej 3 viteve në gjykatën kompetente.

Me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, është ndërprerë rrjedha e parashkrimit vetëm për tri vite paraprake nga data 06 shtator 2013, kur atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës, mirëpo ky njoftim nuk ka mund ta ndërpresë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës për paga për periudhën e mëhershme, meqë për periudhën nga viti 2004 e deri në gusht 2010 parashkrimi tashmë veç kishte

ndodhur. Andaj nga këto arsye me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e kishte refuzuar këtë pjesë të kërkesës për paga për periudhën e cekur.

Prandaj nga arsyet e cekura, refuzohen të dy ankesat e paraqitura, si të pa bazuara, dhe vërtetohet në tërësi Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj nga ajo që u tha më sipër, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 30 euro, me datë 08 qershor 2023, ndërsa AKP-ja në shumë prej 100 euro me datë 12 qershor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 12 prill 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
